



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 2177/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit L... SH.P.K me numër të biznesit, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson S.R Drejtor Gjeneral, kundër debitorëve: I. “Rr...” SH.P.K, me nr. biznesi, në Prishtinë, të cilën e përfaqëson V.Sh dhe II. Sh.A.Sh, Komuna e Ferizajit, duke vendosur sipas parashtrësës së debitorit Rr... SH.P.K, për tërheqjen e prapësimit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 430/2022 të datës 02.08.2022 të Përmbartuesit Privat Bardh B. Tasholli, me seli në Ferizaj, jashtë seancës me datën 21.11.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Hudhet si i palejuar prapësimi i debitorit “Rr...” SH.P.K, i paraqitur kundër urdhrit përmbartimor P.nr 430/2022 të datës 02.08.2022 të Përmbartuesit Privat Bardh B. Tasholli.
- II. MBETET në fuqi Urdhri P.nr. 430/2022 i datës 02.08.2022 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Bardh B. Tasholli.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat Bardh B. Tasholli, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit L... SH.P.K, ka caktuar urdhrin P.nr. 430/2022 me datën 02.08.2022, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit – kontrata e lizingut financiar për persona juridik nr.LS-2022-2021 dhe LS-2022-2036 dhe marrëveshjes për pengun mbi llogaritë bankare nr. LS-2022-2021 dhe LS-2022-2036 mbi financimin e automjetit me përshkrim Opel Astra CDTI, ngjyrë kafe, nr. i shasisë, viti prodhimit 2012 me targa, me financim në shumën prej 8,100.00 € dhe në bazë të marrëveshjes financim personal juridik për financimin e automjetit Volkswagen Caddy, ngjyra e bardhë , nr. i shasisë, viti prodhimit 2011, me targa me financim prej 5,800.00 euro, që të paguaj borxhin në shumën prej 784.71€, dhe atë për kontratën LS-2022-2021 shumën prej 250.18 € dhe shumën prej 534.53 € për kontratën LS-2022-2036, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore në afat

prej 7 ditëve, me bllokimin e të gjitha llogarive nëpër të gjitha bankat komerciale në emër të debitorit duke bërë pagesën me bartje të mjeteve nga llogaria e debitorit në llogarinë e kreditorit.

Kundër urdhrit për lejimin e përmbarimit, brenda afatit ligjor me datën 02.09.2022 prapësim ka paraqitur debitori “RR...” SH.P.K, ndërsa me datën 05.09.2022 përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori.

Debitori me datën 17.10.2022, me anë të parashtresës, e ka njoftuar Gjykatën se e tërheq prapësimin e paraqitur ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr. 430/2022 pasi që ka arritur të përmbush obligimin në tërësi dhe i propozon gjykatës që lëndën ta dërgoj tek përmbaruesi privat pas tërheqjes së prapësimin.

Sipas nenit 67 par.1 të Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (tutje referuar si LPP) prapësimi përcaktohet si mjet i rregullt i goditjes dhe duke marrë parasysh faktin se me këtë ligj nuk është përcaktuar mënyra e vendosjes në rastet e tërheqjes së prapësimin nga e ana e debitorit dhe duke u bazuar në nenin 17 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se *“Në procedurën përmbarimore përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën kontestimore, po qe se me këtë ligj ose me ndonjë ligj tjetër nuk parashihet diçka tjetër.”*, gjykata për vendosjen në rastin konkret zbatoi përshtatshmërisht dispozitat e LPK-së.

Në nenin 186 par. 3 të LPK-së, përcaktohet se *“Ankesa është e palejueshme po që se e ka paraqitur personi që nuk është i autorizuar për paraqitjen e saj, apo personi që ka hequr dorë nga e drejta e ankimit apo që e ka tërhequr ankesën e paraqitur, apo në qoftë se personi që e ka paraqitur ankesën nuk ka interes juridik për paraqitjen e ankesës.*

Gjykata pas vlerësimit të parashtresës së debitorit për tërheqjen e prapësimin të ushtruar me datën 17.10.2022 dhe duke u bazuar në dispozitat e lartcekura, gjeti se prapësimin është i palejuar për shkak prapësimin është tërhequr nga ana e debitorit dhe në mbështetje të nenit 73. par.3 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se *“ Me vendim prapësimin mund të pranohet, refuzohet ose hidhet poshtë si i pa afatshëm, si jo komplet dhe i palejuar”*, e ka hedhur prapësimin si të palejuar, duke vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi dhe e ka lënë në fuqi urdhrin përmbarimor sikurse në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata konform nenit 73 par.3 të LPP-së dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 2177/22, datë 21.11.2022.

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi

palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve,

nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.